




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: (MSH) OE ankues: "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 582/19
Prej:	Hysni Muhadri – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 582/19 të parashtruar nga OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK – Prishtinë.		
Datë	27.09.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 10.09.2019, me nr. 582/19 të parashtruar nga OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale", me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësis (MSH).

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MSH
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruar nga OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale", me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësis (MSH).



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	17.09.2019	27.09.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën:10.09.2019, OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale", me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Shëndetësis (MSH).

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK – Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK – Prishtinë, janë:

- Neni 1 – Qëllimi;
- Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
- Neni 27 – Dosja e tenderit;
- Neni 18 – RRUOPP-së;
- Neni 26 – RRUOPP-së;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Fillimisht ju rikujtojmë se ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale me nr. prokurimi 206-19- 4445-1-1-1. Po ashtu kemi

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruar nga OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale", me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Shëndetësis (MSH).

parashtruar edhe ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit për shkak të vendosjes së kriterëve favorizuese/diskriminuese. Ne kemi parashtruar ankesë për shkak se kriteri ka qenë i vendosur në këtë mënyrë:

“Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: “Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, vëb faqja etj. Për mundësi të verifikimit) Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet të dorëzohet Original ose kopje e noterizuar”.

Pas kësaj anekse, ne kemi kërkuar edhe një interpretim ligjor tek Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP), ndërsa i njëjti institucion me dt.25.06.2019 ka lëshuar një interpretim si në vijim: Njoftimin për kontratë që keni në platformën elektronike “Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale”, me nr. të prokurimit 206-19-4445-111 dhe nr. të Brendshëm 206-19-36-111, ju lutem rishikoni edhe njëherë te Kapaciteti teknik dhe profesional ku keni kërkuar: Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, **në këtë rast Autoriteti Kontraktues është dashtë të kërkojë edhe nga dileri”.**

Ne me datë 02.08.2019. e kemi pranuar njoftim për Korrigjimin e gabimeve, ku është shtuar edhe “Autorizimi nga Dileri” me të dhënat përkatëse, por me datë 26.08.2019., përsëri kemi marr njoftimin për korrigjimin e gabimeve ku është hequr fjalia “Autorizimi nga Dileri”, gjë që është në kundërshtim me përgjigjen e KRPP-së.

Autoriteti kontraktues në fillim e ka marr për bazë interpretimin-sqarimin e KRPP-së në lidhje me këtë çështje, por pastaj ka marr vendim nëkundërshtim me sqarimin e KRPP-së.

Të nderuar, AK-ja tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionalenë nenin9.1 & 9.2 në lidhje me Kapacitetin teknik dhe profesional ka kërkuar **“Te dëshmohet se operaton ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar: Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, vëb faqja etj. për mundësi të verifikimit) Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet të dorëzohet Origjinal ose kopje e noterizuar.**

Përsëri po ju njoftojmë se kjo kërkesë e autoritetit kontraktues është diskriminuese/favorizuese sepse favorizon operatorët ekonomik që janë të lidhur drejtpërdrejtë me prodhuesin, ndërsa diskriminon operatorë ekonomikë tjerë që mund të jenë autorizuar nga dileri apo operatorë ekonomik të rinjë, prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni autoritetin kontraktues që të respektoj interpretim-sqarimin e KRPP-së, dhe të hapet konkurrenca edhe njëherë dhe të ndryshohet kjo kërkesë me përmirësimin **“Autorizim nga prodhuesi apo dileri”**Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 27 të LPP-së dhe nenin 18.4 të RRUOPP, sepse nuk e ka përgatitur dosjen e tenderit mirë dhe në harmoni me qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa neni 18.4 i RRUOPP, shkruan qartë **“TVë dosjen e tenderit AK-ja do të deklaronte të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE- të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë.**

Informata të tilla do të **përfshijnë** të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. Të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. **Çdo fjalë në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiai themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre.**

Gjithashtu neni 18.9 i RRUOPP-së përcakton qartë **“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:**

Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Ne me dt:03.09.2019 kemi marrë përgjigje nga ana e autoritetit kontraktues ku është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim të cilën autoriteti kontraktues e ka cilësuar si të pa bazuar dhe nuk ka dhënë ndonjë arsye faktike dhe ligjore për këtë vendim.

Duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura dhe në kërkesën e AK-së, atëherë rezulton se me kërkesën që OE të ofrojnë dëshmi për autorizimin vetëm nga prodhuesi, kufizohet konkurrenca dhe favorizohen kompani të caktuara dhe njëkohësisht diskriminohen kompanitë tjera konkurruese.

Kërkesa e autoritetit kontraktues në lidhje me autorizimin është në kundërshtim edhe me nenin 7. Paragrafi 6 të LPP-sëku Shkruan: Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;(i)pjesëmarrjen sa më të mëdhejmë dhe lëndë prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave. Informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj;(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundërnjë ose më shumë operatorë ekonomik.

Gjithashtu neni 26.4 i RRUOPP parasheh qartë që "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK-ja do të kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formulojë kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike.

Prandaj autoriteti kontraktues është dashur të merr parasysh operatorët ekonomik të themeluar rishtazi me qëllim që të mos iu kufizohet konkurrenca.

Po ashtu me kërkesat e lartpërmendura mund të mos përmbushet qëllimi i këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa veprimet e autoritetit kontraktues mund të bien ndesh edhe me qëllimin e LPP-së, ku në nenin 1 të këtij ligji parashihet qartë që "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë".

Nëse veprohet më tutje me këto kërkesa dhe në këtë mënyrë, autoriteti kontraktues rrezikon seriozisht të dëmtojë buxhetin sepse në momentin kur kufizohet konkurrenca për prodhues të caktuar, atëherë mundësia është shumë e madhe që të ofrohen çmime shumë më të larta, se sa vlera e tregut, prandaj edhe rrezikohet të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të LPP-së dhe natyrisht cenohet edhe neni 6 i LPP-së.

Duke pasur parasysh argumentet dhe faktet e lartcekura, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa si e bazuar e OE "PHARMA LEADER L.L.C

DETROHET autoriteti kontraktues të ndryshojë kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, konkretisht të përmirësohet kërkesa në lidhje me autorizimin dhe të përcaktohet si në vijim: **Autorizim nga prodhuesi apo dileri dhe të veprohet konform neni 53 të LPP-së.**

Në të kundërtën ne do të vazhdojmë me procedura tjera në instancat tjera në instancat tjera kompetente.

Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta me pretendimet e shënuar në ankesën për rishqyrtim.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë.....	24.06.2019
Lloji i procedurës së aplikuar.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar.....	Kontratë publike furnizim
Vlera e parashikuar e kontratës.....	4, 411.458.30 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Data e kërkesës për rishqyrtim OE	12.07.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	15.07.2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	15.07. 2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	23.07. 2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	01.08. 2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	08.08. 2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	23.08. 2019
Data e njoftimit – përmasimi i gabimit	03.09. 2019
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	16.09.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- 1.Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
2. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- 1.Deklarata nën Betim.
2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente - vetëm për fituesin para dhënies së kontratës.
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore - vetëm për fituesin para dhënies së kontratës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesat e parashtruara nga OE "PHARMA LEADER L.L.C" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale", me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Shëndetësis (MSH).

<p>(shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para publikimit të Njoftimit për dhenje të Kontratës]</p> <p>3. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.</p>	
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit.</p> <p>2. Regjistrimi ne regjistrin Fiskal.</p> <p>3. Certifikata për TVSH për secilin partner te një grupi operatorësh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove;</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1. Certifikata e Biznesit –Kopje.</p> <p>2. Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal – kopje.</p> <p>3. Kopje e Certifikatës se TVSH-se – kopje.</p>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1. Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi.</p> <p>2. Te dëshmohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPM, me dozën e produktit te kërkuar.</p> <p>3. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike.</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1. Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, per mundësi te verifikimit) Autorizimi duhet te jet i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet te dorëzohet Original ose kopje e notorizuar.</p> <p>2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPM sipas UA 01 2015, me dozën e produkteve te kërkuara, Kërkohet kopje.</p> <p>3. Licenca nga AKPM si qarkullues me shumice i produkteve farmaceutike (me validitet) Kërkohet kopje.</p>

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “PHARMA LEADER L.L.C” SHPK – Prishtinë.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se për titullin e aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale**, me numër të prokurimit: 206-19-4445-111, është parashtruar ankes nga OE **“PHARMA LEADER L.L.C” SHPK**, me nr. 440/2019, me datë: 25.07.2019, dhe për të njejtën ankesë është kërkesa për tërheqje nga i njëjti OE me datë: 26.07.2019, e ku me datë: 01.08.2019, është nxjerrur vendimi ku i është aprovuar kërkesa për tërheqje, si dhe i është lejuar AK-së, që të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se në kohën kur është bërë kërkesa e OE **“PHARMA LEADER L.L.C” SHPK**, për tëheqje të ankesës në OSHP, me datë:26.07.2019, ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë: **“Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, per mundësi te verifikimit) Autorizimi duhet te jet i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet te dorëzohet Original ose kopje e notorizuar”, dhe në ankesën e datë:24.7.2019, ndër pretendimet ka qenë edhe pretendim se kërkesa e cekur më lartë është**

*diskriminuere/favorizuese sepse e favorizon operatorin e ekonomik që është i lidhuer drejtpërdrejt me prodhuesi, është kërkuar nga operatori ekonomik në fjalë që kjo kërkesë të përmisohet e të kërkohet **Autorizim nga prodhuesi apo dileri**.*

*Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se OE "MEDITECH" SHPK, me datë: 31.07.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues ku ka sqaruar se kërkesën "**Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, ëb faqja etj, për mundësi të verifikimit)**" Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet të dorëzohet **Original ose kopje e notorizuar**", me datë: 17.07.2019, AK-së e ka ndryshuar në kundërshtim me legjisllacionin në fuqi. .*

*Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, sqaron se me datë:31.07.2019, është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar, dhe me datë:05.08.2019, OE "MEDITECH" SHPK, i drejtohet sekretarit të MSH, drejtorit të AKPMM-së dhe departamentit të prokurimit në MSH, ku e kundërshton ndryshimin e kërkesës së njoftimit për kontratë dhe të dosjes së tenderit "**Autorizim nga prodhuesi apo dileri**", duke u thirrur në bazën ligjore që e regullon fushën e produkteve farmaceutike.*

Përgjigje në Pretendimi nr.1

*Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, sqaron se AK-së, me datë:03.09.2019, nxjerr Vendim ku e refuzon kërkesën për rishqyrtim të "**PHARMA LEADER L.L.C**" SHPK, të datës **30.08.2019**.*

Eksperti shqyrtues sqaron se përmes këtij Vendimi është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, vazhdohet me tutje me këtë vendim, ku ndër të tjera thuhet:

Në bazë të Ligjit Nr.04/L-042, për Prokurim të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe Udhëzuesve Operativ të Prokurimit Publi. Si autoritet kontraktues e kemi ri shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe pretendimet tuaja ankimore janë të pa bazuar.

Autoriteti kontraktues e ka bërë plotësim ndryshimin e Dosjes së Tenderit sipas shkresës së dërguar nga KRPP, mirëpo pas plotësimit ndryshimit kemi pranuar kërkesë për rishqyrtim nga një operator tjetër ku ka atakuar plotësim ndryshimin e bërë në lidhje me autorizimin nga Prodhuesi ose Dileri.

Autoriteti kontraktues duke marrë parasysh dispozitat juridike të nenit 16 të Ligjit 04/L – 190 Për produkte dhe pajisje Medicinale, me të cilin është përcaktuar që produkti medicinal mund të plasohet në Republikën e Kosovës, vetëm pas marrjes së Autorizimit për marketing nga AKPPM-ja (Agjencia Kosovar për produkte dhe pajisje medicinale).

Po ashtu zbatimin e kësaj dispozite, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.01/2015, Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale me të cilin janë kushtet, kriteret dhe procedurën për dhënien e së drejtës së ri përfitjes, prodhimit dhe tërheqjes së Autorizim marketingut.

Neni 6 pika 6 e Udhëzimit Administrativ 01/2015, Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale e përcakton se kush mundet të plasoj produktin në tregun e Kosovës.

*Citat: **Bartës i autorizim marketingut, është përgjegjës për autorizim marketingun dhe për plasimin e produkteve medicinal në treg. Caktimi i një përfaqësuesi nuk e liron mbajtësin e autorizim marketingut prej përgjegjësisë së tij ligjore.***

Duke u bazuar në nenet e lartëcekura shihet se për plsimin e produkteve medicinal në tregun e Kosovës është përgjegjës bartësi i Autorizim marketingut- Prodhuesi e jo Dileri.

Konstatohet se Autorizimi nga prodhuesi nuk e kufizon tregun për arsye se me asnjë kriter të tenderit nuk kufizohet konkurrenca, pasi që prodhuesi (bartësi AM) mund të jep autorizim për pjesëmarrje në tender 1 apo më shumë ose pjesëmarrës në tender, siç hasim në praktik gjatë procedimit të tenderëve të natyrës së ngashëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës, sqaron se KRPP me datë.25.06.2019, ka lëshuar një interpretim si në vijim: **Njoftimin për kontratë që keni në platformën elektronike “Furnizim me Insulina nga Lista Esenciale”, me nr.të prokurimit 206-19-4445-111 dhe nr.të Brendshëm 206-19-36-111, ju lutem rishikoni edhe njëherë të Kapaciteti teknik dhe profesional ku keni kërkuar: Te dëshmohet se operatori ekonomik është i autorizuar nga prodhuesi, në këtë rast Autoriteti Kontraktues është dashtë të kërkojë edhe nga dileri”.**

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Meqenëse nuk jam ekspert i fushës së shëndetësisë, mirëpo duke pasur Vendimin me nr. 440/2019, të datës:01.08.2019, ku I është aprovuar kërkesa për tërheqje të ankesës dhe I është lejuar AK-së që të vazhdohet më tutje me aktivitetin e prokurimit, nenin 16 të Ligjit 04/L – 190 Për produkte dhe pajisje Medicinale, me të cilin është përcaktuar që produkti medicinal mund të plasohet në Republikën e Kosovës, vetëm pas marrjes së Autorizimit për marketing nga AKPPM-ja (Agjencia Kosovare për produkte dhe pajisje medicinale), dhe Neni 6 pika 6 e Udhëzimit Administrativ 01/2015, ku thuhet Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale e përcakton se kush mundet të plasoj produktin në tregun e Kosovës, si dhe duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me produkt të rëndësishëm për jetën e pacientëve, mendoj se duhet të jetë kërkesa e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë **“Autorizimi nga prodhuesi për tenderin përkatës (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, ëeb faqja etj, për mundësi të verifikimit) Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për vitin aktual dhe kërkohet të dorëzohet Original ose kopje e notorizuar”,**

Gjithashu duke pasur parasysh se njoftimi për kontratë është bërë me 24.06.2019 dhe tani jemi në muajn e nëntë, një operator ekonomik serioz është dashur të sigurojë një autorizim nga prodhuesi.

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku pretendon se kriteri i kërkuar është kriter kufizues, bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së, ku thuhet: **“Autoriteti kontraktues është dashtë të kërkojë autorizim nga prodhuesi ose dileri”,** eksperti shqyrtues sqaron se në këtë interpretim NUK specifikohet decidivisht që autorizimi të kërkohet edhe nga dileri, si dhe duke pasur parasysh që KRPP i monitoron të gjitha dosjen e tenderit, AK-së ka mundur të ndërhyjë dhe të mos të lejojë vendosjen e kriterëve kufizues/favorizues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigjet), dhe ti lejohet autoritetit kontraktues që vazhdojë më tutje me këtë aktivitet të prokurimit